



e Rahovecit

Hapet Festa e Vjeljes së Rrushit

Festa e Vjeljes së Rrushit – Hardh Fest, është një festë e bujqve dhe e vreshtarëve tanë për të ndarë prodhimet e punën e tyre.

Për tri ditë, më 6, 7 dhe 8 shtator, qytetarë nga Kosova, bashkëkombës nga trevat shqiptare dhe nga vende të ndryshme të botës, morën pjesë në aktivitetet e begatshme dhe në koncertet e festivalit.

Komuna e Rahovecit është përkrahëse e vazhdueshme e këtij festivali. Vizitorët nga brenda dhe jashtë vendit nuk vijnë vetëm për të festuar, por edhe për të përjetuar atë që Rahoveci ka për të ofruar: një traditë të pasur, mikpritje të ngrohtë dhe produkte të cilësisë së lartë. Kjo krijon mundësi të reja për vreshtarët tanë, për bizneset lokale dhe për të gjithë komunitetin tonë.

Në kuadër të festës, është edhe hapja e panairit të verërave dhe mundësia e shijimit.



Miratohet buxheti për vitin 2025

Në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Rahovecit, u miratua buxheti për vitin 2025. Buxheti kap vlerën 20.982.796.00€ dhe synon të realizojë një sërë projektsh të rëndësishme për zhvillimin e komunës.

